

**Akt Themelimi
I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar
“SmartALB” Sh.p.k.**

Ne Tirane, sot me date 01 dhjetor 2023, une themeluesi:

Julian Muçobega i biri i Bashkimit, i dtl. 21.05.1979, lindur ne Kamçisht, tepelene, Shqiperi dhe banues ne Rr. Muzaket, Ndertesa 27 , Shkalla 2, Ap.75 , Tirane, Shqiperi, shtetas shqipetar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. H90521055E, i cili me cilesine e “ortakut themelues”, me vullnet të lire, të plete e të sinqerte hartoje kete akti themelimi per krijimin e shoqerise pergjegjesi te kufizuar me emertimin “SmartALB”

Sh.p.k. (me poshte e quajtur “Shoqeria mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare ” te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “ “SmartALB” Sh.p.k., eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”).

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKR, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria “SmartALB” Sh.p.k., është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i vetem”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortaku përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Ortaku gëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne Tirane, ne adresen : “Rruga Muzaket, Ndertesa 27, Hyrja 2, Apartamenti 75. Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Vetem.

Julian Muçobega

Neni 4

Objekti i veprimitarise

Tregetim, import-eksport i paisjeve elektronike, informatike, elektrike, hidraulike, mekanike, te linjave dhe makinerive, te aparaturave mjeksore te pjeseve te ndryshme te kembimit te siperpermendura.

Instalim i linjave e kabinave elektrike te tensionit te ulet e te mesem.

Tregeti, import-eksport, i sistemeve te vezhgimit, akses kontrolli, sistemeve te mbrojtjes kundra zjarrit, UPS, radio nderlidhje. Mirembajtje te aparaturave te siperpermendura, suport teknik, konsulencë teknologjike.

Tregtim te sistemeve per perpunimin e te dhenave te te gjitha llojeve, hardware, software dhe te gjithe periferikeve te tyre. Zhvillim software, lojra elektronike, programe te ndryshme.

Mirembajtje godinash publike edhe jo publike, qendra biznesi etj.

Instalime hidraulike, kanalizime (shtrim dhe instalim kabujsh), aktivitete (punime) arkitekturore. Aktivitete te tjera per perfundimin e ndertesave. Punime te tjera per perfundimin e ndertesave Konsulencë teknike ne fusha te ndryshme, supervizion, menaxhim dhe studime te te gjitha llojeve. Kryerjen e provave, mbikqyrjen, inspektimet, marrje ne dorezim, marrjen e mostrave, sondazhe, ekspertiza, ne lidhje me strukturat, objektet, pajisje, mjetet dhe makineri, si dhe te gjitha llojet e produkteve teknologjike e industriale, me qellim sigurimin e cilesise, funksionalitetin, fizibilitetin, kursimin dhe sigurine gjate ndertimit, funksionimin, perdorimin, riparimin, largimin ose riperdorimin e tyre. Kryerje e kurseve profesionale kualifikimi.

Shoqeria do te ushtroje te gjitha aktivitetet te lejuara nga ligji, duke perfshire edhe prodhimin, punetorine dhe sherbimet te krijuara nga shoqeria vete. Sherbime telekomunikacioni, sherbime ne komunikimet web, foto, filme dhe sherbime kundrejt shoqerive qe merren me komunikimet web. Importe-eksporte, tregtimin e te gjitha llojeve te mallrave, materialeve, makinerive, automjeteve, pajisjeve.

Shoqeria mund te kryeje edhe veprimitari te tjera ndihmese te cilat mbeshtesin arritjen e qellimit te saj kryesor ne perputhje me legjisacionin ne fuqi. Mund te kryeje cdo operacion financiar tregtar, sherbimi, industrial, me pasuri te luajtshme ose te paluajtshme.

Zhvillimi e veprimitarive ne fushen e turizmit, transportit, te udhetareve, perqatitja e guidave, tour operator, etj.

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per nje periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKR.

KREU II

KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100,000 lekë, i ndare ne nje kuote, kontribut i ortakeve themelues ne masen:

Z. Julian Bashkim Muçobega, eshte zoterues i 1 kuote me vlore 100,000 leke, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku perjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7

Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund të zvogëlohet me vendim të Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkoen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim

nga administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjeter të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU II

ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9

Organ Vendimmarres

Ortaku i Vetem eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Ortaku i Vetem eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Ortaku i vetem, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
- b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- ç) përcaktimin e shpërbllimeve
- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e

Julian Mucobega 

pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë; e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënët e të cilët nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- investime;
- vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejtë në mirëbesim, përvèç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10 Administrimi

Administrator i shoqerise eshte Z.Julian Muçobega , i biri i Bashkimit , i dtl. 21.05.1979, lindur ne Kamçisht, Tepelene, Shqiperi dhe banues ne Rruga Muzaket, Ndertesa 27,Hyrja 2,Apartamenti 75, Shqiperi, shtetas shqipetar, madhor, me zotesi juridike dhe per te vepruar, identifikuar nepermjet kartes se identitetit me nr. H90521055E.

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per një afat 5 vjecar me te drejte riparteritje.


Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Ortakut te Vetem te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe një person i trete jashte ortakerise.

Neni 11 Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga ortaku i vetem;
- përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- kujdeset përmbytjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatisi dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpëra ortakut te vetem për miratim;
- krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryejë regjistrimet dhe dërgoj të dhënët e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raportojë përpëra asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori eshte i detyruar të thërrasi mbledhjen e ortakut te vetem edhe ne rastet kur :
sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë



më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certikuara,

Administratori ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoritetet shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoritetet doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoroin këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori eshte përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Ortaku i Vetem që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimitarës së shoqërisë në mjesht;

b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;

c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;

ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjen ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.


4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare , kryen veprimet e mëposhtme:

a) u kthen ortakëve kontributet;

b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;

c) u shpërndan aktivet shoqërisë;

ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimitarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;



d) jep kredi.

Neni 13
Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor 2023.

Neni 14
Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut te Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut te Vetem vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15
Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Ky Akt themelimi i shoqerise "SmartALB" SH.P.K., u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakut themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE
z. Julian Muçobega

Julian Muçobega

Dt. 1/12/2023